



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KOMISIONERI PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT DHE MBROJTJEN E TË
DHËNAVE PERSONALE

DREJTORIA PËR MBROJTJEN E TË DHËNAVE PERSONALE

Nr. 1630/1 prot.

Tiranë më 31.10.2019

Lënda: Përgjigje kërkesës për mendim

AUTORITETIT TË MBIKËQYRJES FINANCIARE

Tiranë

Zyra e Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale u njoh me kërkesën tuaj, administruar me nr. 1630 prot, datë 16.10.2019, dhe me rrethanat e parashtruara nga ana juaj. Paraprakisht, vlerësojmë angazhimin tuaj në respekt të detyrimeve ligjore dhe në këtë kuadër, ju bëjmë me dije lidhur me disa detyrime që keni në cilësinë e kontrolluesit, në kuadër të respektimit të legjislacionit në fushën e mbrojtjes së të dhënave personale.

Në nenin 3, pika 1, e Ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale", i ndryshuar, parashikohet: "Të dhëna personale" është çdo informacion në lidhje me një person fizik, të identifikuar ose të identifikueshëm, direkt ose indirekt, në veçanti duke iu referuar një numri identifikimi ose një a më shumë faktorëve të veçantë për identitetin e tij fizik, fiziologjik, mendor, ekonomik, kulturor apo social.

Në këtë kuadër, vlerësojmë se, nëse nëpërmjet numrit të shasisë së një mjeti identifikohet subjekti i të dhënave (pronari i mjetit) atëherë kjo e dhënë konsiderohet si e dhënë personale dhe si e tillë duhet pasur parasysh se përpunimi i ligjshëm i të dhënave personale bëhet duke respektuar dhe garantuar të drejtat dhe liritë themelore të njeriut dhe, në veçanti, të drejtën e ruajtjes së jetës private.

Në rastin tuaj, nëse nëpërmjet aplikacionit për verifikimin e historikut të mjeteve motorike të përfshira në aksidente, nuk identifikohen subjektet e të dhënave personale (pronarë të mjeteve) atëherë ky informacion lidhur me historikun e një mjeti nuk konsiderohet si e dhënë personale dhe si i tillë nuk ka pengesë ligjore për zhvillimin e këtij funksionaliteti me qëllim verifikimi.

Në të kundërt, nëse aplikacioni për verifikimin e historikut të mjeteve nëpërmjet numrit të shasisë së një mjeti lejon identifikimin e subjektit të të dhënave (pronarin e mjetit)

atëherë përhapja/aksesi në këto të dhëna të subjekteve të të dhënave, konsiderohet
përpunim dhe përpunimi i të dhënave personale legjitimohet vetëm nëse plotësohet një
nga kushtet e sanksionuara në nenin 6 të Ligjit nr.9887, datë 10.03.2008 "Për Mbrojtjen
e të Dhënave Personale", i ndryshuar.

Duke ju falënderuar për bashkëpunimin,

KOMISIONERI

Besnik Dervishi

